



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:228313

Datë: 03.09.2024

Numri i dokumentit: 06193655

KA.nr.403/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ të paditësit “Kompania Rajonale e Mbeturinave Pastrimi” ShA me NUI 811276957 dhe me seli në rrugën “Tahir Zajmi” nr. 5 në Prishtinë, kundër të paditurit Inspektorati i Punës me seli në Prishtinë, objekti i kontesti anulimi i aktit administrativ, jashtë seancës, më 3 shtator 2024 dha këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Kompania Rajonale e Mbeturinave Pastrimi” ShA me NUI 811276957 kundër të paditurit Inspektorati i Punës, dhe anulohet në tërësi vendimi me nr. 218 i datës 02.07.2024 i Komisionit të Organit të Shkallës së Dytë të Inspektoratit të Punës dhe çështja administrative në shkallë të dytë vendoset si në vijim:

Aprovohet ankesa e parashtruesit “Kompania Rajonale e Mbeturinave Pastrimi” ShA me NUI 811276957 dhe anulohet tërësisht vendimi 01Nr.48-45-1/2023 i datës 12.03.2024 i Inspektoratit të Punës, si organ administrativ i shkallës së parë.

- II. Ky aktgjykim i zëvendëson aktin administrativ të anuluar me pikën I të këtij dispozitivi.

A R S Y E T I M

I. Padia, kërkesëpadia dhe pretendimet e palëve

1. Paditësi përmes padisë së datës 20.08.2024, të ndryshuar përmes parashtrësës së datës 30.08.2024, e ka iniciuar konfliktin administrativ me kërkesë për anulimin e vendimit me nr. 218 i datës 02.07.2024 i Komisionit të Organit të Shkallës së Dytë të

Inspektoratit të Punës. Si pjesë të padisë ka paraqitur edhe kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ, kundër vendimit të goditur.

2. Në padi ka deklaruar se vendimi është nxjerrë në kundërshtim me të drejtën materiale dhe është nxjerrë si rezultat i konstatimit të gabuar të gjendjes faktike. Më tutje e ka pretenduar se i Padituri me refuzim të ankesës nuk e ka analizuar të drejtën materiale, sipas të cilës Punëdhënësi gëzon të drejtën të organizoj punën sipas nenit 24 të Ligjit të Punës. Sipas tij, lidhur me këtë rast është dërguar raporti me prezantimin e dokumenteve si dëshmi që punonjësi është lajmëruar në ATK, kontratë të punës, është kompensuar me orë shtesë, punën gjatë festave dhe fundjavave.
3. Nga përmbajtja e vendimit të shkallës së parë rrjedh se Inspektorati i Punës në shkallën e parë e kishte aprovuar ankesën e një punëmarrëses së Paditësit dhe kishte konstatuar se Paditësi si punëdhënës e kishte shkelur nenit 56 e sanksionuar me nenin 92 të Ligjit 03/L-212 të Punës, si dhe i kishte shqiptuar Paditësi gjobë në lartësi prej 3000€. Këtë vendim e kishte arsyetuar me konstatimin e tij se Paditësi si punëdhënës nuk e ka kompensuar ankuesin (punonjësin e vet) për punën jashtë orari, punën e festave dhe punën gjatë fundjavës.
4. Ndërsa nga përmbajtja e vendimit të shkallës së dytë rezulton se i Padituri e ka refuzuar ankesën e Paditësit dhe e ka vërtetuar vendimin e shkallës së parë, ndonëse Paditësi e kishte kundërshtuar kompetencën e të Paditurit.
5. Për këtë gjykatë, çështjet e vendosura me vendimet e shkallës së parë të së Paditurit, të vërtetuara përmes vendimit të shkallës së dytë, paraqesin kontest nga marrëdhënia e punës, meqenëse neni 56 i Ligjit 03/L-212 të Punës (këtu e tutje LP), për të cilin i Padituri ka gjet shkelje dhe e ka gjobitur Paditësin, rregullon kushtet dhe obligimin e punëdhënësit që ta paguaj punëmarrësin për punën më të gjatë se orari i plotë i punës, si dhe për punë në ditët e festave shtetërore dhe për punën e natës.
6. Pavarësisht faktit se i Padituri me vendimin e tij nuk e ka obliguar Paditësin që të përmbush ndonjë detyrim nga marrëdhënia e punës, megjithatë detyrimi i punëdhënësit nga neni 56 i LP-së i përket marrëdhënies së punës mes palëve, përmbushjen e të cilit duhet ta vlerësoj gjykata. Pra, vlerësimi se (i) a e ka punëdhënësin për obligim që punëmarrësit t'ia paguaj punën më të gjatë se orari i plotë i punës, si dhe për punë në ditët e festave shtetërore dhe për punën e natës, dhe (ii) a e ka përmbushur punëdhënësi atë obligim, bien në fushën e kontesteve nga marrëdhënia e punës.

7. Për pasoj, meqenëse Inspektorati i Punës nuk mund të bëjë asnjë vlerësim lidhur me çështjet nga neni i 56 i LP-së, atëherë ai juridikisht e ka të pamundshme të shqiptoj gjyba për mos përmbushjen e atij obligimi.

## II. Vlerësimi meritor i rastit

8. Gjykata pas i mori parasysh të gjitha pretendimet e palëve, pasi i shqyrtoi të gjitha shkresat e lëndës, si dhe pas analizimit të dispozitave juridike të cituara më poshtë, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e Paditësit është e bazuar në ligj, si dhe çështje mund të vendoset pa shqyrtim gjyqësor në bazë të nenit 35 të LKA-së.
9. Gjykata në rend të parë e shqyrtoi kompetencën e të Paditurit për të vendosur për kontestet e punës, si në vendimet e goditura. Kompetencat e të Paditurit, pra Inspektoratit të Punës, rregullohen me Ligjin 03/L-212 të Punës (këtu e tutje LP) dhe Ligjin nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjit Nr. 03/L-017 (këtu e tutje LIP).
10. LP në nenin 82 para. 1 ka rregulluar se *“I punësuar në çdo kohë mund t’ia dorëzojë ankesën Inspektoratit të Punës për çështje të cilat bien nën kompetencat e këtij organi”, si dhe në nenin 84 ka përcaktuar se “Mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji të cilat e rregullojnë marrëdhënien e punës, sigurinë dhe mbrojtjen në punë, e bën Inspektorati i Punës në bazë të Ligjit për Inspektoratin e Punës dhe Ligji Nr. 2003/19 për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mbrojtjen e ambientit të punës”.*
11. Përveç kësaj, LP në nenin 79 ka rregulluar se *“Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente”.* Për më tepër, neni 80 i LP-së në para. 1 ka rregulluar se *“1. Nëse gjykata konstaton se ndërprerja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit është joligjore, në bazë të dispozitave të këtij ligji, Kontratës Kolektive ose Kontratës së Punës, atëherë do të urdhërojë punëdhënësin që të ekzekutoj njërën prej këtyre dëmshpërblimeve: 1.1. t’i paguajë të punësuarve kompensimin, përveç shtesave dhe shumave tjera të cilat i takojnë punonjësit në bazë të këtij ligji, Kontratës së Punës, Kontratës Kolektive ose Aktit të Brendshëm, në shumën të tilla që gjykata i konsideron të drejta dhe adekuate, por të cilat nuk duhet të jenë më*

*pak se dyfishi i vlerës së çdo dëshmëpërblimi që i takon punonjësit në kohën e shkarkimit; ose 1.2. nëse largimi nga puna vlerësohet si i paligjshëm sipas nenit 5 të këtij ligji, Gjykata mund ta rikthejë të punësuarin në vendin e tij të punës dhe urdhëron kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve tjera të humbura gjatë gjithë kohës së largimit të paligjshëm nga puna”*

12. Siç kuptohet nga këto nene, një punëtor mund t’i drejtohet Inspektoratit të Punës për çështjet të cilat bien në kompetencën e tij, ndërsa kur është i pakënaqur me vendimin e punëdhënësit që i prek të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës, atëherë ai brenda 30 ditëve e ka të mundshme që t’i drejtohet gjykatës kompetente për të kërkuar mbrojtje të të drejtave të tij ose realizimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës.
13. LIP në nenin 2 ka përcaktuar *“Inspektorati i punës: a) Do të mbikqyrë zbatimin e ligjit të punës, Ligjit për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës, si dhe dispozitave tjera të aplikueshme nga fusha e punësimit dhe mbrojtjes në punë; b) Do t’iu siguroj informacion teknik dhe këshilla punëdhënësëve dhe punëtorëve për çështjet më të efektshme të zbatimit të dispozitave ligjore; c) Do të njoftoj ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale apo ndonjë organ tjetër kompetent për ndonjë mungesë apo ndonjë shpërdorim në ligjin e aplikueshëm; d) Do t’iu siguroj informatat dhe këshillat punëdhënësve dhe punëmarrësve të cilat do të jenë në pajtim me ligjin dhe t’i paralajmërojnë autoritetet kompetente për çfarëdo defektesh apo shpërdorimesh që nuk janë përfshirë me dispozita ligjore ekzistuese”*. Nga ky nen nuk rrjedhë asnjë kompetencë e Inspektoratit të Punës që të zgjidh konteste nga marrëdhënia e punës.
14. Nga dispozitat e cituara më lartë kuptohet se ligjvënësi nuk i ka dhënë kompetenca Inspektoratit të Punës që të zgjidh konteste nga marrëdhënia e punës. Rrjedhimisht, i Padituri nuk ka pasur kompetencë që të konstatojë shkelje nga neni 56 i LP për Paditësin si punëdhënës, rrjedhimisht as të shqiptoj gjobë për shkeljet e nenit 56 të LP-së. Vlerësim i këtyre çështjeve, si konteste nga marrëdhënia e punës, është kompetencë ekskluzive gjyqësore, siç rrjedh nga neni 79 dhe 80 i LP-së.
15. Gjykata rikujton se çështja e kompetencave të Inspektoratit të Punës ishte sqaruar edhe me aktgjykimin AGj.2098/22 të datës 16.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në rastin KO27/21, i cili në paragrafin 100 ka sqaruar se *“Për me tepër, asnjë normë e Ligjit të Punës dhe e Ligjit nr. 2002/9 për Inspektoratin e*

*Punës, nuk parasheh apo nënkupton që Inspektoratit të Punës t'i jepet autoritet me attribute të një "gjkate" apo të një "tribunali te pavarur". Gjykata rikujton se neni 79 i Ligjit të Punës do të ishte i pakuptimte dhe i pazbatueshem, sepse kjo dispozite e përcakton gjykatën si të vetmin autoritet publik në Republikën e Kosovës që do të vendose për "kontestet e punës" dhe të drejtat e punës te garantuara me Kushtetute dhe Ligjin e Punës", ndërsa në paragrafin 104 ka përfunduar se "Gjykata verën se Ligji i Punës, Ligji për Inspektoratin e Punës, Ligji për Siguri dhe Mbrojtje ne pune, mandatojne Inspektoratin e Punës për mbikëqyrjen e zbatimit te këtyre ligjeve në pajtim me fushëveprimin dhe funksionet e përcaktuara ne nenin 1 dhe 2 te Ligjit nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës. Por, as në dispozitat e këtij ligji, ligjeve te tjera dhe as nga gjuha e nenit 94 te Ligjit te Punës, nuk mund te kuptohet e as te nënkuptohet që një organ inspektues mund te përvetësoje funksione gjyqësore. Gjuha e normës kushtetuese është e qartë. Funksione gjyqësore mund te ushtrojnë vetëm gjykatat, sipas parimeve te përcaktuara me Kushtetute dhe ligjet përkatëse"*

16. Bazuar në sqarimet e mësipërme, gjykata përfundimisht vlerëson se i Padituri Inspektorati i Punës ka tejkaluar kufijtë e kompetencës së tij kur ka vlerësuar se a e përmbushur Paditësi obligimin e punëdhënësit për ta paguar punëmarrësin për punën më të gjatë se orari i plotë i punës, si dhe për punë në ditët e festave shtetërore dhe për punën e natës, të cilat me ligj të veçantë janë përcaktuar si kompetenca për një institucion tjetër, në këtë rast të gjykatës. Shkelja e tillë përbën shkak për anulimin e aktit administrativ sipas nenit 52 para. 1 nënapra. 1 të LPPA-së lidhur me nenin 16 para. 1 nëpara. 2 të LKA-së, meqenëse ai nuk ka qenë i autorizuar që të nxjerr aktet administrative të goditura.
17. Prandaj, gjykata gjeti se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet dhe karakteri i çështjes e lejon që gjykata të vendos me juridiksion të plotë, si dhe të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, rrjedhimisht me aktgjykim vendosi për çështjen administrative, siç mundëson neni 46 para. 4 i LKA-së. Po ashtu, në bazë të njëjtit paragraf gjykata rikujtoi se ky aktgjykim e zëvendëson aktin e anuluar.
18. Në këtë drejtim gjykata sqaron se, kur çështja administrative vendoset me vendim gjyqësor në konflikt administrativ, atëherë gjykata i merr të gjitha kompetencat e organit administrativ, vendimi i të cilit kundërshtohet me padi. Meqenëse në rastin konkret organ administrativ është organ i shkallës së dytë (organ epror) duke vepruar

sipas ankesës së Paditësit, atëherë gjykata i kishte autorizimet e atij organi administrativ që dali nga neni 132 para. 4 i LPPA-së, sipas të cilit *“Nëse organi epror vlerëson se ankesa është e pranueshme dhe e bazuar, ai duhet të vendosë përfundimisht me një akt të ri që të anulohet apo ndryshohet, plotësisht apo pjesërisht, aktin e ankimuar, gjegjësisht do të nxjerrë aktin e kërkuar nga pala”*.

19. Gjkata rikujton se, ligjshmëria e aktit administrativ të kontestuar shqyrtohet nga gjykata brenda kufijve të kërkesës nga padia, por nuk obligohet nga shkaqet e padisë, siç parasheh neni 44 para. 1 i LKA-së, ndërsa për nulitetin (paligjshmërinë) e aktit administrativ gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, siç urdhëron neni 44 para. 2 i LKA. Kjo nënkupton se, gjykata e shqyrton ligjshmërinë e aktit administrativ të goditur edhe për arsye të cilat paditësi nuk i nga ngritur para gjykatës.
20. Gjkata vendosi që çështjen konkrete ta zgjidh pa seancë dhe pa e dërguar padinë për përgjigje, pasi vlerësoi se janë plotësuar kushtet nga neni 35 i LKA-së, sipas të cilit *“Nëse gjykata nuk e hedh poshtë padinë në bazë të paragrafit 2. të nenit 33, apo në bazë të nenit 34 të këtij ligji, kurse konstaton se akti administrativ i kontestuar përmban të meta esenciale, që e pengojnë të çmuarit e ligjshmërisë së aktit, e anulon me aktgjykim, aktin administrativ edhe pa e dërguar padinë në përgjigje.”*
21. Kështu, gjykata në rend të parë gjeti se padia është e plotë, është e kuptueshme dhe nuk ka të meta, si dhe nuk ekziston asnjëra nga shkaqet nga neni 34 të LKA-së. Në anën tjetër, siç është sqaruar më lartë, shkeljet janë esenciale që e pengojnë çmuarjen e ligjshmërisë së aktit administrativ të goditur, rrjedhimisht për këtë gjykatë nuk pati nevojë që të caktohet seancë. Përveç kësaj, mungesa e kompetencës së organi administrativ është shkak shprehimor për paligjshmërinë e aktit administrativ, që shpie te anulimi i tij sipas nenit 16 para. 1 nënpara. 1.2 të LKA-së.
22. Meqenëse vendimi i goditur është nxjerr me tejkalim të kompetencave, atëherë provat dhe pretendimet tjera të ndërgjyqësve nuk ishin relevante për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit administrativ të goditur, rrjedhimisht gjykata nuk i shqyrtoi fare ato.
23. Lidhur me kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ, gjykata vendos me aktvendim të veçantë.
24. Prandaj gjykata përfundimisht vlerëson se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, rrjedhimisht duhet të aprovet. Për këto arsye, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12

lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Komerciale e Kosovës

Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.403/22

Gjyqtari

---

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktgjykimit mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.